



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më	12.02.2025
Nr.	958 prot.

Data: 12.2.2025

Nr: 88

Ora: 18:00

VENDIM

PËR

NJË NDYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE NR. 44, DATË 28.1.2025, "PËR CAKTIMIN E NJËSIVE ADMINISTRATIVE KU DO TË KRIJOHEN SELITË E KOMISIONEVE TË ZONAVE PËR ADMINISTRIMIN ZGJEDHOR, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND, TË DATËS 11 MAJ 2025"

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat "b" dhe "n", dhe nenit 93, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë",

VËREN:

Njësitë administrative ku do të krijohen Selitë e KZAZ-ve për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025, janë përcaktuar me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 44, datë 28.1.2025, "Për caktimin e njësive administrative ku do të krijohen selitë e Komisioneve të Zonave për Administrimin Zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 maj 2025", sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur vendimit.

Kryetarët e Bashkive, sipas përcaktimeve të pikës 2, të këtij vendimi, kanë siguruar infrastrukturën logjistike, ambientin dhe mjetet e punës, për krijimin e Selive të KZAZ-ve,

Kryetari i Bashkisë Has, me shkresën e administruar pranë nesh, me nr. 935 prot., datë 12.2.2025, ka informuar KQZ-në, se ambienti i propozuar nga Bashkia Has dhe i miratuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 44, dt. 28.1.2025, nuk është mundësuar të sigurohet aksesimi për anëtarët e KZAZ-së nr. 10, dhe ka propozuar që ambienti i selisë të zhvendoset pranë Konviktit "Kosova", në Krumë.

Data: 12.2.2024 Nr: 88
Ora: 18:00



"Për një ndyshim në vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 44, datë 28.1.2025 "Për caktimin e njësive administrative ku do të krijohen selitë e Komisioneve të Zonave për Administrimin Zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025"

Administrata e KQZ-së, e pranishme në terren, ka inspektuar ambientin e ri të propozuar dhe vlerëson se është në përputhje me kërkesat e nenit 15, të Vendimit nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, njësi administrative e propozuar, ofron baraslargësi nga qendrat e votimit të ZAZ-së respektive, si dhe lehtësi logjistike të transportit rrugor.

Në bazë të përcaktimeve të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencën të ndryshojë pjesërisht aktin e nxjerrë prej tij, në ushtrim të kompetencave të parashikuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

PËR KETO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat "b" dhe "n" dhe pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"

VENDOS:

1. Ndryshimin e selisë së Komisionit të Zonës për Administrimin Zgjedhor (KZAZ) nr. 10, Qarku Kukës, Bashkia Has, në tekstin e lidhjes nr. 1 të vendimit nr. 44, datë 28.1.2025, si më poshtë:
 - Nga: “Salla e Mbledhjeve, Zyra vendore e Arsimit ParaUniversitar, Adresa: Sheshi "Luan Haradinaj” në: “Ambientet e Konviktit “Kosova”, Kati 2, Rruga Kastriotët, Krumë”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI